



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 18 të Udhëzimit administrativ nr. 06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, nenit 13 të Udhëzimit administrativ (MPL) nr. 03/2020, për transparencë në komuna, nenit 32, pika **c** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.05.2022, merr këtë

V E N D I M

PËR KONSULTA PARAPRAKE PUBLIKE LIDHUR ME PROJEKTRREGULLOREN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS NR. 01-030/01-0134831/18 E DT. 06.06.2018

I.

MIRATOHET Vendimi për lënie në shqyrtim publik të Projektregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Prishtinës nr. 01-030/01-0134831/18 e dt. 06.06.2018.

II.

Lidhur me Projektregulloren e cekur në pikën I, komisioni do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar, përmes formave të fshatave informative, kontakteve me grupe të interesit dhe palët e interesuara për t'i diskutuar propozimet.

III.

Konsultat paraprake publike për projektregulloren e cekur në pikën I të këtij vendimi, do të zgjasin 30 ditë.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë tjera kompetente.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-020/01-103489/22, më 12.05.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

